



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 9894 prot.

Vlorë, më 21.08 2023

PROJEKT -VENDIM

Nr. _____ , datë ____ . ____ . 2023

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA E BANESËS TË Z. BESNIK ÇOBO NË DATËN 05.06.2023, DHE
SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z. Besnik Çobo, e ndodhur në lagjen “15 Tetori”, Rajoni Nr.1, Bashkia Vlorë, në datën 20.06.2023, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

● 42.285(dyzet e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë për punime ndërtimi.
(84.571x50%)

● 44.019(dyzet e katër mijë e nëntëmbëdhjetë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

KRYETARI

ERMAL DRËDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 9894 prot.

Vlorë, më 21.08 2023

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.BESNIK ÇOBO NË DATËN 05.06.2023 DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLOREË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë, në datën 16.06.2023 ka paraqitur kërkesën z. Besnik Çobo me Nr.7234 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen "15 Tetori", Rajoni Nr.1, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr. 12 datë 19.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 20.06.2023, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.7234/1 prot, date 21.07.2023 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z. Besnik Çobo, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.1326/01, datë 03.08.2023 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të z. Besnik Çobo në lagjen "15 Tetori" Rajoni Nr1, ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

1. Vlera e dëmeve në banesën e z.Besnik Çobo është 86.304 (tetëdhjet e gjashtë mijë e treqind e katër) lekë

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjen për banesën e djegur.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Besnik Çobo në datën 05.06.2023 sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile i Bashkisë Vlorë.

DREJTORI I MBROJTJES CIVILE

Aulon SPAHO



Koncept: E.Kamberi



Pranoi: O.BEJTO

